



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vlorë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

**KONTRATË**

**NDËRMJET**

**STUDENTIT DHE KOLEGJIT UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"**

Lidhur sot në Vlorë, më \_\_\_\_\_, në selinë e Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" (më poshtë KUPV), në adresën: Bulevardi "Ismail Qemali", Vlorë - Skelë, këtu e në vazhdim referuar si "Kontrata ndërmjet palëve", mes:

**Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë"**, me liçencë të dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 279, datë 12.09.2009, me përfaqësues Prof. Dr. Luan GJONCAJ - Rektor, këtu e në vazhdim referuar si "**KUPV**", dhe

**Z/Znj.** \_\_\_\_\_, me ID \_\_\_\_\_ i Diplomës së Maturës Shtetërore, ose Nr. i Regjistrimit të veçantë \_\_\_\_\_ i Dëftesës së Pjekurisë; i/e biri/bija, i/e \_\_\_\_\_, lindur në \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, banues në \_\_\_\_\_, me Nr.pasaporte /ID \_\_\_\_\_, Adresë elektronike \_\_\_\_\_, Nr. Kontakti \_\_\_\_\_, këtu e në vazhdim referuar si "**Studenti**".

Të dy së bashku, referuar si "**Palët e Kontratës**", bien dakord me kushtet e mëposhtme:

**I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Të dhëna mbi Programin, KUPV dhe Regjistrimin**

Me anë të kësaj Kontrate, KUPV e regjistron Studentin në Fakultetin \_\_\_\_\_ në programin \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, (180 kredite, 4500 orë mësimore të ndara në leksione, seminare në auditor dhe orë studimi individuale); në vitin akademik \_\_\_\_\_.

Studenti e fiton statusin juridik të studentit me regjistrimin në KUPV dhe e humbet atë me marrjen e diplomës, çregjistrimin apo me përjashtimin e tij nga KUPV.

## Neni 2

### Tarifa e shkollimit , pagesa dhe tarifa të tjera

#### 2.1. Tarifa e shkollimit

Me regjistrimin në KUPV, studenti është i detyruar të paguajë tarifën e shkollimit që është \_\_\_\_\_ euro/.

Tarifa e shkollimit përfshin pagesën për frekuentimin e procesit mësimor, pjesëmarrjen në aktivitetet akademike e shkencore që parashikon zhvillimi i programit të studimit, si dhe aktivitete të tjera ekstrakurrikulare që zhvillohen në KUPV, kryerjen e praktikave mësimore, diplomimin, shfrytëzimin e internetit, bibliotekës, si dhe të shërbimeve të ndryshme të KUPV.

#### 2.2. Mënyra e pagesës.

Palët bien dakort për mënyrën e pagesës e cila i bashkëngjitet kësaj kontrate dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

#### 2.3. Tarifa të tjera për procesin akademik.

Lista e tarifave të tjera miratohet dhe shpallet në fillim të çdo viti akademik. Këto tarifa aplikohen në rastet e mëposhtme:

- a. Në rastin kur studenti nuk frekuenton procesin mësimor në masën e përcaktuar në rregullore, ai/ajo humbet të drejtën për të hyrë në provimin përfundimtar të lëndëve ku ka tejkaluar numrin e lejuar të mungesave dhe është i/e detyruar t'i rindjekë ato, kundrejt tarifës përkatëse prej **100 euro** për lëndë.
- b. Studenti/ja ka të drejtë të rijapë (për t'a marrë) provimin për një lëndë, deri në 2 (dy) herë pa pagesë, në sezona provimi dhe riprovimi. Në vijim, studenti/ja hyn në riprovim kundrejt pagesës prej **50 euro** për çdo rihyrje.
- c. Studenti/ja ka të drejtë të përmirësojë vetëm 2 (dy) provime në një vit akademik, në sezonin e riprovimeve, kundrejt pagesës përkatëse prej **100 euro** për çdo provim.

## II. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTIT

### Neni 3

#### Të drejtat dhe detyrimet e studentit

##### *Studenti ka të drejtë:*

- a. Të ndjekë leksionet, seminarat dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore;
- b. Të përfitojë nga procesi akademik dhe të diplomohet pasi të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara në programin e studimit;
- c. Të përdorë mjediset e KUPV për realizimin e programit akademik;
- d. Të ripërfitojë, për vitet e ardhshme, zbritjen e tarifës së shkollimit të aplikuar për vitin e parë akademik si tarifë bursimi, nëse arrin ta mbajë gjatë studimeve në KUPV notën mesatare mbi pragun e caktuar;